



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06/IA026

Vendosi: **Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit**
Gjykatëse Mishelë Pikar
Gjykatës Emilio Gati
Gjykatës Kai Ambos

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 7 shkurt 2023

Gjuha origjinal: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Kërkesën për Zgjatjen e Afatit për Dorëzimin e Apelit Kundër
Vendimit të Katërt mbi Pjesëmarrjen e Viktimave**

Zyrës së Prokurorit të Specializuar:
Aleks Uajting

Mbrojtjes së Hashim Thaçit:
Gregori Kihou

Mbrojtësit të Viktimave:
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit:
Ben Emerson

**Mbrojtëses së Parashtruesve të
Kërkesave të Refuzuara,:**
Jelena Cakiq

Mbrojtjes së Rexhep Selimit:
Dejvid Jang

Zyrës së Pjesëmarrjes së Viktimave:
Tadeja Novinc

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit:
Venkatesvari Alagenda

PANELI I DHOMËS SË GJYKATËS SË APELIT i Dhomave të Specializuara të Kosovës (përkatësisht “Paneli i Gjykatës së Apelit”, “Paneli i Apelit” ose “Paneli” dhe “Dhomat e Specializuara”),¹ në zbatim të nenit 33(1)(c) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullës 169 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave (“Rregullorja”) ka marrë një kërkesë të bërë nga mbrojtësja e parashtruesve të kërkesave për viktimë 23/06, 29/06, 30/06, 31/06, 32/06, 42/06, 43/06, 48/06, 49/06, 50/06, 51/06, 52/06, 60/06, 61/06, 62/06, 69/06, 81/06, 83/06 dhe 87/06 (bashkërisht, “Parashtrues të Kërkesave të Refuzuara”)² – kërkesat e të cilëve për të marrë pjesë në procesin gjyqësor u gjykuan të papranueshme më 12 dhjetor 2022 në “Versionin e Redaktuar Publik të Vendimit të Katërt mbi Pjesëmarrjen e Viktimave” (“Vendim i Kundërshtuar”)³ – e cila kërkon zgjatjen e afatit për të paraqitur apel kundër Vendimit të Kundërshtuar të 15 shkurtit 2024 (“Kërkesa”).⁴

1. Mbrojtësja e Parashtruesve të Kërkesave të Refuzuara parashtron se duke marrë parasysh numrin e parashtruesve të refuzuar, vendin ku ata banojnë, vështirësitë e sigurisë dhe udhëtimit, si edhe kohën e emërimit të saj, ajo nuk ka pasur mundësi t’i takojë të gjithë personalisht (pas marrjes nga ana e tyre të njoftimit të Vendimit të Kundërshtuar).⁵ Gjithashtu ajo thotë se: (i) i nevojitet kohë që të mbledhë materialin e munguar nga kërkesat fillestare të Parashtruesve të Kërkesave të Refuzuara; (ii) nuk mund të punësojë një ekip që ta ndihmojë; (iii) trajnimin në Legal

¹ IA026/F00002, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, 3 shkurt 2023 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, riklasifikuar si publik më 7 janar 2023).

² F01182, Njoftim për Caktimin e Dy Mbrojtësve për Parashtruesit e Kërkesave të Refuzuara, 28 dhjetor 2022; F01182/A02, Shtojca 2 e Njoftimit për Caktimin e Dy Mbrojtësve për Parashtruesit e Kërkesave të Refuzuara, 28 dhjetor 2022 (konfidencial dhe *ex parte*). Paneli vëren se një parashtrues tjetër i kërkesës për pjesëmarrje si viktimë përfaqësohet nga një mbrojtës tjetër i caktuar; shih F01182/A01, Shtojca 1 e Njoftimit për Caktimin e Dy Mbrojtësve për Parashtruesit e Kërkesave të Refuzuara, 28 dhjetor 2022 (konfidencial dhe *ex parte*).

³ F01152, Versioni Publik i Redaktuar i Vendimit të Katërt mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, 14 dhjetor 2022 (version rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* parashtruar në 12 dhjetor 2022) (“Vendimi i Kundërshtuar”).

⁴ IA026/F00001, Kërkesë për Zgjatjen e Afatit për Dorëzimin e Apelit Kundër Vendimit të Katërt mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, 2 shkurt 2023 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*) (“Kërkesë”).

⁵ Kërkesa, para. 15, 17-18.

Workflow e bëri vetëm më 1 shkurt; (iv) në kohën e Kërkesës, shumica e parashtruesve të kërkesave të refuzuara ishin u njoftuar për Vendimin e Kundërshtuar më 23 janar 2023, por dy prej tyre nuk ishin njoftuar ende; dhe (v) gjykimi është planifikuar të fillojë më 1 mars 2023, dhe do të ishte efikase që, meqenëse argumentet për secilin parashtrues do të ishin thujse të njëjtë, të parashtronte një kërkesë të përbashkët për të gjithë Parashtruesit e Kërkesave të Refuzuara.⁶

2. Paneli rikujton se, në zbatim të rregullës 113(6) të Rregullores, personave të cilëve u refuzohet kërkesa kanë të drejtën e apelimit vetvetiu të vendimit brenda katërmbëdhjetë (14) ditësh.⁷ Për më tepër, në bazë të rregullave 9(2) dhe 113(5) të Rregullores, afati i lartpërmendur fillon prej ditës së parë të punës pas njoftimit mbi vendimin që i bëhet parashtruesit të kërkesës të refuzuar.⁸ Gjithashtu, rregulla 9(5)(a) e Rregullores lejon ndryshimin e afatit të përcaktuar nga Rregullorja nëse tregohen arsye të vlefshme.⁹

3. Rrjedhimisht, afati i paraqitjes së apeleve në emër të Parashtruesve të Kërkesave të Refuzuara të njoftuar për Vendimin e Kundërshtuar më 23 janar 2023 ishte 6 shkurt 2023, ndërsa afati i paraqitjes së apeleve në emër të Parashtruesve të Kërkesave të Refuzuara që nuk ishin njoftuar ende për Vendimin e Kundërshtuar në kohën kur është paraqitur Kërkesa do të jetë 14 ditë pune që nga data e njoftimit në fjalë.¹⁰

⁶ Kërkesa, para. 16, 19-23.

⁷ IA005/F00003, Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes për Sqarim dhe Ndryshim të Afatit, 31 maj 2021, ("Vendimi i Apelit në lidhje me Afatet"), f. 2.

⁸ Vendimi i Apelit në lidhje me Afatet Kohorë", f. 2; F00159, Vendim Kornizë mbi Parashtrimin e Kërkesave nga Viktimat, 4 janar 2021, para. 55. Paneli gjithashtu thekson se në Vendimin e Apelit në lidhje me Afatet ka konstatuar se "për hir të drejtësisë ndaj parashtruesve të kërkesave, në pajtim me rregullën 113(6) të Rregullores afati duhet të fillojë nga dita e parë e punës pas njoftimit të parashtruesit të kërkesës mbi Vendimin në një gjuhë të cilën ai ose ajo e kupton, e cila mund të jetë e ndryshme nga gjuha e punës në këtë çështje"; shih Vendimi i Apelit në lidhje me Afatet", f. 3.

⁹ Vendimi i Apelit në lidhje me Afatet", f. 4.

¹⁰ Shih Vendimi i Apelit në lidhje me Afatet", f. 3.

4. Paneli konstaton se janë paraqitur arsye të vlefshme për zgjatjen e afatit të paraqitjes së apeleve në emër të Parashtruesve të Kërkesave të Refuzuara që janë njoftuar për Vendimin e Kundërshtuar më 23 janar 2023, si për shembull që paraqitja e një apeli të përbashkët në emër të të gjithë grupit të Parashtruesve të Kërkesave të Refuzuara do të ishte përsheptuese.¹¹ Në lidhje me këtë, Paneli gjithashtu vëren në kohën kur u paraqit Kërkesa, dy nga Parashtruesit e Kërkesave të Refuzuara nuk ishin njoftuar ende për Vendimin e Kundërshtuar, që do të thotë se afatet e mundshme për dorëzimin e apeleve të tyre kundër Vendimit të Kundërshtuar në çdo rast do të mund të jenë edhe përtej afatit të kërkuar të 15 shkurtit 2023.¹² Rrjedhimisht, Paneli gjykon se do të ishte në interes të drejtësisë të lejohej Mbrojtësja e Parashtruesve të Kërkesave të Refuzuara që të paraqiste apele kundër Vendimit të Kundërshtuar deri në datën 15 shkurt 2023, ose shtatë ditë pasi të jenë njoftuar të gjithë Parashtruesit e Kërkesave të Refuzuar për Vendimin e Kundërshtuar, cilado datë që është e mëvonshme, si edhe konstaton se një gjë e tillë nuk do të ndikojë negativisht në shpejtësinë e përgjithshme të këtij procesi gjyqësor.¹³

5. Gjithashtu, Paneli rikujton se, në zbatim të rregullës 9(6) të Rregullores, vendimi mbi një mocion për ndryshimin e afateve mund të merret duke mos i dhënë palës kundërshtuese mundësinë e shprehjes së mendimit.¹⁴ Krahas kësaj, Paneli vëren se në rastin në fjalë Kërkesa është paraqitur *ex parte* nga palët dhe nuk është paraqitur ende as në formë konfidenciale, as në formë publike ndonjë version i redaktuar, që do të kishte krijuar mundësinë çdonjëres prej tyre që t'i përgjigjej asaj. Rrjedhimisht, duke pasur parasysh ngutshmërinë procedurale të Kërkesës, dhe duke qenë se palëve nuk do t'u shkaktohet ndonjë dëm, Paneli mendon se është në interes të drejtësisë që vendimi mbi këtë Kërkesë të nxirret menjëherë.¹⁵ Gjithashtu Paneli konstaton se, duke

¹¹ Vendimi i Apelit në lidhje me Afatet”), f. 4; shih edhe Kërkesa, para. 23.

¹² Vendimi i Apelit në lidhje me Afatet”), f. 4.

¹³ Vendimi i Apelit në lidhje me Afatet”), f. 4.

¹⁴ Vendimi i Apelit në lidhje me Afatet”), f. 4.

¹⁵ Vendimi i Apelit në lidhje me Afatet”), f. 4.

marrë në konsideratë rëndësinë e afateve të paraqitjes së apeleve në funksionimin si duhet të Dhomave të Specializuara, Mbrojtësja e Parashtruesve të Kërkesave të Refuzuara duhej t'i kishte paraqitur kërkesat sa më shpejt që të ishte e mundur.

6. Së fundi, Mbrojtësja e Parashtruesve të Kërkesave të Refuzuara e parashtron kërkesën në formë rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* duke cituar klasifikimin e Vendimit të Kundërshtuar.¹⁶ Megjithatë, Paneli konstaton se Vendimi i Kundërshtuar ka qenë i disponueshëm në formë publike të redaktuar që më 14 dhjetor 2022. Rrjedhimisht, në të mirë të parimit të proceseve publike në Dhomat e Specializuara, Paneli i Apelit urdhëron Mbrojtësen e Parashtruesve të Kërkesave të Refuzuara të parashtrojë një version të redaktuar publik të Kërkesës brenda shtatë ditësh nga marrja e njoftimit për këtë Vendim.

7. Për arsyet e lartpërmendura, Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit:

MIRATON Kërkesën;

URDHËRON Mbrojtësen e Parashtruesve të Kërkesave të Refuzuara të paraqesë apelet kundër Vendimit të Kundërshtuar deri në datën 15 shkurt 2023 ose shtatë ditë pasi të jenë njoftuar të gjithë Parashtruesit e Kërkesave të Refuzuara për Vendimin e Kundërshtuar, cilado datë që është e mëvonshme; dhe

URDHËRON Mbrojtësen e Parashtruesve të Kërkesave të Refuzuara të parashtrojë një version të redaktuar publik të Kërkesës brenda shtatë ditësh nga marrja e njoftimit për këtë Vendim.

/nënshkrimi/

¹⁶ Kërkesa, para. 1 (f. 6). Paneli konstaton se ka një gabim në numërtimin e paragrafëve, si për shembull ky paragraf, që duhej të kishte numrin "24", ka numrin "1".

**Gjykatëse Mishelë Pikar,
Kryegjykatëse**

E martë, 7 shkurt 2023

Në Hagë, Holandë